



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

Nr. 2566 Prot.

Tiranë, më 26 04 2019

Lënda: Kërkesë për plotësim dokumentacioni

Z. IBRAHIM FEMI SAKO

Adresa: Lagjja nr. 3, Cërrik

Për dijen!

KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 04, Tiranë

PARTISË DEMOKRATIKE

Adresa: Bulevardi "Zhan Dark", nr 11, Tiranë

Me shkresën nr. 792/1 prot., datë 25.02.2019, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës, në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, vakancë kjo e krijuar si pasojë e dorëheqjes nga mandati i Deputetit, z. Luçiano Dhimitër Boçi, i zgjedhur në zonën zgjedhore, Qarku Elbasan, propozuar nga subjekti politik, Partia Demokratike.

Referuar nenit 164 të Kodit Zgjedhor, kandidati vijues nga lista shumemërore e Partisë Demokratike, për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, të cilit i kalon mandati i Deputetit, është kandidati me numër rendor 13, z. Ibrahim Femi Sako.

Referuar nenit 11, të ligjit nr.138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", për çdo kandidat të listave shumemërore për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, për shkak të plotësimit të vakancave duhet të kryhet, vetëdeklarimi për garantimin e integritetit dhe verifikimi i të dhënave.

Përpara plotësimit të vakancës në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, kandidati i listës shumemërore të Partisë Demokratike, z. Ibrahim Femi Sako, duhet të depozitojë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, brenda 10 ditëve, formularin e vetëdeklarimit për garantimin e integritetit të kandidatit.

Nëse subjekti nuk depoziton formularin e vetëdeklarimit brenda afatit të sipërcituar, konsiderohet se refuzon propozimin e organit kompetent për kandidim, zgjedhje apo emërim dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve shpall faktin e moszgjedhshmërisë.

Ju bëjmë me dije se formulari i vetëdeklarimit duhet të jetë i plotësuar në kompjuter, në të gjitha seksionet e tij dhe në rast se ndonjë nga pjesët e formularit nuk mund të plotësohet, për mungesë të faktit, atëherë personi duhet të shënojë me vizë (/) atë pjesë, në mënyrë që të shmangët plotësimi apo rregullimi i mëvonshëm i saj, në përputhje me Kreun II, pika 7, dhe Kreun III pika 2, e Vendimit të Kuvendit nr.17/2016, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr.138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"





KQZ
U PROTOKOLLUA
NR2608
30.04.19

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Tiranë, më 30/04/2019

LËNDA: Kthim përgjigje njoftimit të KQZ, duke konfirmuar refuzimin për të dorëzuar Formularin e Vetëdeklarimit për Dekriminalizimin

DREJTUAR: KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

BAZA LIGJORE: Pika 2, neni 5 i ligjit nr. 138/2015

Të nderuar anëtarë të KQZ-së,

Unë, **Ibrahim Femi Sako**, kandidatë nga lista shumëemërore e Partisë Demokratike të Shqipërisë, jam njohur me njoftimin tuaj për mandatin e deputetit dhe thirrjes për plotësimin e dokumentacionin përkatës. Në njoftim theksohet se përpara plotësimit të vakancës së krijuar në Kuvend me personin tim, unë duhet të bëjë vetëdeklarimin për garantimin e integritetit, duke plotësuar dhe dërguar brenda 10 ditëve nga momenti i njoftimit, Formularin e Vetëdeklarimit për efekt të procesit të Dekriminalizimit.

Ashtu siç ju kam bërë me dije edhe më parë, nisur nga rrethanat në të cilat ndodhet vendi, nuk pranoj zgjedhjen apo mandatin e deputetit për në Kuvendin e Shqipërisë, të cilin e konsideroj ilegalitet dhe të dalë nga një proces i deformuar zgjedhor, i diktuar nga fenomeni i blerjes së votave dhe përfshirjes së grupeve kriminale në zgjedhje.

Në këto kushte, në mbështetje të nenit 5, pika 2, të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", me vullnet të lirë, deklaroj se **REFUZOJ** të dorëzojë Formularin e Vetëdeklarimit, duke refuzuar të pranoj propozimin e KQZ për kandidimin, zgjedhjen apo emërimin.

Përsa më lart, lutem ndjekjen e menjëhershme të procedurës ligjore për shpalljen e moszgjedhshmërisë time në funksionin e deputetit, në përputhje me nenin 5 të ligjit nr. 138/2015.

Me respekt,
Ibrahim Femi Sako

Ibrahim Femi Sako
(emër, atësi, mbiemër, nënshkrimi)




RR 846 802 606 AA

NUESE E LAJMERIMIT

...datë..... 28 APR 2019

Është pranuar në zyrën.....

Në drejtim të zyrës
E POROSITUR



Ibrahim Sako

PROFESUAR NGA ZYRA MARRËSE E OBJEKTIT

Objekti i sipërtreguar është.....

Emri i mbiemri.....

Emri i marrësit të objektit.....


Roguar.....

Emri i mbiemri.....

i shpërndarësit.....

SHËNIME TË VECANTA
SERRETI TË TIJ

Villaduruesi i zyrës
Dërguese të objektit



onair



POSTA SHQIPTARE sh.a.
Zyra Postare

Vula e Zyrës Pranuese të Lajmerimit

LAJMERIM MARRJE NR.....

Ky lajmerim - marrje do të kthehet
në adresën time si më poshtë:

Plotësohet nga dërguesi
i cili duhet të tregojë drejtimin
e tij të plotë për kthimin
e këtij lajmërimi

Mod P6


Ibrahim Rugova
Tirane

Ibrahim Sako.



Fut kodin e objektit postar dhe kliko Gjurmo./Enter the item number you want to track, then click Submit.

RR846802606AA



Gjurmo/Submit

RR846802606AA

Data	Ngjarja	Zyra	Destinacioni
01-05-2019 02:19 AM	Objekti dhene postierit per dorezim / Unsuccessful attemp at delivering the object (Inb)	Shpermdaresia Tirane, TIRANA	
30-04-2019 18:25 PM	Objekti u nxor nga thesi per perpunim / Receive item at location (Inb)	Shpermdaresia Tirane, TIRANA	
30-04-2019 17:57 PM	Skenuar per transport / Scan to transport	Dispeceria Tirane, TIRANA	Shpermdaresia Tirane, TIRANA
30-04-2019 17:09 PM	Mberritje objekti ne destinacion / Receive item at location (Otb)	Dispeceria Tirane, TIRANA	
30-04-2019 17:04 PM	Skenuar per transport / Scan to transport	ZP Elbasan Qender, ELBASAN	Dispeceria Tirane, TIRANA
30-04-2019 17:01 PM	Objekti u fut ne thes / Insert item into bag (Otb)	ZP Elbasan Qender, ELBASAN	Shpermdaresia Tirane, TIRANA
30-04-2019 09:35 AM	Objekti u rikthye ne origjine / Object returned to sender	ZP Elbasan Qender, ELBASAN	
29-04-2019 06:42 AM	Objekti dhene postierit per dorezim / Unsuccessful attemp at delivering the object (Inb)	ZP Elbasan Qender, ELBASAN	
29-04-2019 06:15 AM	Objekti u nxor nga thesi per perpunim / Receive item at location (Inb)	ZP Elbasan Qender, ELBASAN	

© Powered by Helius Systems

29-04-2019 06:03 AM	Mberitje objekti ne destinacion / Receive item at location (Otb)	ZP Elbasan Qender, ELBASAN	
27-04-2019 20:50 PM	Skanuar per transport / Scan to transport	Dispeceria Tirane, TIRANA	ZP Elbasan Qender, ELBASAN
27-04-2019 20:46 PM	Skanuar per transport / Scan to transport	Tranziti i Brendshem, TIRANA	Dispeceria Tirane, TIRANA
27-04-2019 19:11 PM	Objekti u fut ne thes / Insert item into bag (Otb)	Tranziti i Brendshem, TIRANA	ZP Elbasan Qender, ELBASAN
27-04-2019 18:08 PM	Objekti u nxor nga thesi per perpunim / Receive item at location (Inb)	Tranziti i Brendshem, TIRANA	
27-04-2019 17:06 PM	Skanuar per transport / Scan to transport	Dispeceria Tirane, TIRANA	Tranziti i Brendshem, TIRANA
27-04-2019 16:33 PM	Skanuar per transport / Scan to transport	ZP Tirana 5, TIRANA	Dispeceria Tirane, TIRANA
27-04-2019 16:29 PM	Objekti u fut ne thes / Insert item into bag (Otb)	ZP Tirana 5, TIRANA	Tranziti i Brendshem, TIRANA
27-04-2019 11:57 AM	Pranim objekti nga klienti / Receive item from customer	ZP Tirana 5, TIRANA	